



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

DHE SPORTIT

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES
PËR MATURËN SHTETËRORE**

(Provim me zgjedhje për shkollat e mesme artistike, dega “Art figurativ”)

LËNDA:

HISTORI ARTI

Koordinatori: Majlinda Hala

Viti shkollor: 2014 -2015

TIRANË

JANAR, 2015

1. UDHEZIME TË PËRGJITHSHME

Programi orientues për lëndën me zgjedhje “Histori arti” përfshin njohuritë, konceptet dhe aftësitë më të rëndësishme të “Historisë së artit” për shkollën e mesme artistike profesionale të sistemit 4-vjeçar.

Programi orientues për provimin me zgjedhje “Histori arti”, mbështetet në udhëzimin Nr. 1, datë 12.01.2015 të MAS-it për “Zhvillimin e Provimeve të Maturës Shtetërore 2015” dhe përbën një dokument të vlefshëm për shkollat e mesme artistike dega “Art figurativ”, për nxënësit e interesuar dhe për specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimin e Maturës Shtetërore.

Programi:

- Gjeneron informacionin e nevojshëm për mësuesit e historisë së artit të shkollave artistike, që do të përgatisin maturantët për provimin “Histori arti”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Orienton nxënësit për materialet kyçe mësimore, *njohuritë, konceptet* dhe *aftësitë kryesore*, që ata duhet të zoterojnë për të përballuar me sukses provimin “Histori arti”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Përbën, gjithashtu, një *dokument zyrtar* që duhet zbatuar me korrekësi nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit “Histori arti”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.

Programi orientues “Histori arti” synon vlerësimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nxënësve në këtë lëndë.

Programi orientues është strukturuar në bazë të disa rubrikave që ndjekin dhe sqarojnë njëra-tjetrën.

Ato janë:

1. Tematikat që përshkruajnë përbajtjen e programit.
2. Përshkrimi i tematikës dhe objektivat.
3. Tabela e peshave.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes dhe korrekësi nga secili prej grupeve të interesuara, sidomos kujdes duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit “Histori arti”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore, të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Vëmendje duhet të

tregojnë këta specialistë edhe në lidhje me sigurimin e balancës midis përqindjes që zë secila temë studimi në këtë program me përqindjet që zënë këto tema në testin e provimit.

Përgatitja e nxënësve për provimin “Histori arti” duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme, duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, koncepteve të historisë së artit dhe aftësive të përcaktuara në program. Për të arritur këtë, herë-herë ata duhet t'u rikthehen dhe çështjeve të ndryshme, të cilat nuk janë parashikuar në program, por që përmbytë informacion bazë për të përvetësuar materialin e zgjedhur për provim.

2. TEMATIKAT E PËRMBAJTJES SË PROGRAMIT

- 1) Arti figurativ në Antikitet (3000 vjet p.e.s. – 400 e.s.)**
- 2) Arti në Mesjetë (shekujt XI - XV)**
- 3) Rilindja Europiane (shekujt XV - XVII)**
- 4) Arti Barok (shekujt XVII - XVIII)**
- 5) Arti i Kohës së Re (shekujt XVII - XX)**
- 6) Arti në shekullin XX**
- 7) Arti figurativ shqiptar**

3. TEMATIKA

1. Arti figurativ në Antikitet (3000 vjet p.e.s. – 400 e.s.)

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e artit të mbretërive të vjetra: Egjiptian - të Mesopatamisë; artit grek; artit romak. Përmes njohjes së zhvillimit të artit në këtë periudhë, nxënësit mësojnë dhe kuptojnë ndikimet dhe karakteristikat e saj historike, shoqërore dhe kulturore; rolin e besimit në zhvillimin e artit të këtyre kulturave, mënyrën e qeverisjes dhe të organizimit të jetës shoqërore; zhvillimin e skulpturës monumentale, të varrit, pikturën, arkitekturën, idenë mbi të bukurën dhe kanunet.

| Nr | Tematika | Objektivat |
|----|--|--|
| 1. | Arti figurativ në Antikitet (3000 vjet p.e.s. – 400 e.s.) | <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none">- njohin zhvillimin e artit figurativ në antikitet.- shpjegojnë sistemin shoqëror dhe risitë e kësaj periudhe.- analizojnë gjinitë e artit sipas epokave.- përcaktojnë format dhe teknikat.- shpjegojnë tiparet kryesore të kësaj periudhe. |

2. Arti në Mesjetë (shekujt XI - XV)

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e artit pamor dhe përfaqësuesit kryesorë në periudhën e Mesjetës. Përmes njohjes së zhvillimit të artit në periudhën mesjetare, që përfshin, artin bizantin, artin romanik, artin gotik, Pararilindjen dhe Kristianizmin në Europë, nxënësit mësojnë dhe kuptojnë ndikimet dhe karakteristikat e saj historike, shoqërore dhe kulturore; analizojnë pikturën, skulpturën dhe arkitekturën; ndikimin e pikturës kishtare në të gjithë artin e Mesjetës, ku një vend të veçantë zë edhe njohja me përfaqësuesit dhe veprat e tyre kryesore.

| Nr | Tematika | Objektivat |
|----|--|--|
| 2. | Arti në Mesjetë (shekujt XI - XV) | <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none">- njohin zhvillimin e artit figurativ në Mesjetë.- shpjegojnë rolin e kishës, fuqizimin e feudalizmit, kërkesa e tyre, zhvillimet sociale. |

| | | |
|--|--|---|
| | | <ul style="list-style-type: none"> - shpjegojnë: <ul style="list-style-type: none"> ○ <i>karakteristikat e artit biznatin;</i> ○ <i>karakteristikat e artit romanik;</i> ○ <i>karakteristikat e artit gotik;</i> ○ <i>karakteristikat e artit të Pararilindjes;</i> - krahasojnë periudhat midis tyre. |
|--|--|---|

3.Rilindja Europiane (shekujt XV - XVII)

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e artit pamor dhe përfaqësuesit kryesorë në periudhën e Rilindjes Europiane. Përmes njohjes së zhvillimit të artit, nxënësit mësojnë dhe kuptojnë që Rilindja është një lëvizje e mendimit, e cila përfshiu letërsinë, artet dhe shkencat. Në këtë periudhë, nxënësit do të njihen me termin “epoka e humanizmit” dhe do të analizojnë pse u quajt e tillë. Ndriçimi i figurës së njeriut dhe teknikat e reja në të gjitha fushat e artit figurativ do të tregojnë më së miri për botëkuptimin e periudhës së Rilindjes. Perceptimi i ri i hapësirës, tashmë në mënyrë shkencore, i dha një dimension të ri veprës së artit pamor. Njohja me përfaqësuesit dhe me veprat e tyre më të njohura zë një vend shumë të rëndësishëm në këtë periudhë.

| Nr | Tematika | Objektivat |
|----|---|---|
| 3. | Rilindja Europiane (shekujt XV - XVII) | <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohin zhvillimin e artit figurativ në Rilindjen Europiane. - kuptojnë ndikimin e zhvillimeve shoqërore, historike dhe artistike në artin figurativ. - shpjegojnë karakteristikat e kësaj periudhe, si: <ul style="list-style-type: none"> ○ <i>Forcimi i borgjezisë.</i> ○ <i>Zbulimet e mëdha gjeografike.</i> ○ <i>Reformacioni i kishës.</i> ○ <i>Zhvillimi i teknikës.</i> ○ <i>Filosofia humaniste.</i> - njohin autorët kryesorë dhe veprat e tyre. - argumentojnë rreth përsosjes së teknikave |

| | | |
|--|--|---|
| | | artistike në artet figurative. - bëjnë dallimet në kohë dhe në hapësirë. |
|--|--|---|

4.Arti barok (shekujt XVII - XVIII)

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e artit pamor dhe përfaqësuesit kryesorë në periudhën e artit barok. Përmes njohjes së zhvillimit të artit në këtë periudhë, nxënësit mësojnë dhe kuptojnë ndikimet dhe karakteristikat e saj historike, shoqërore dhe kulturore; analizojnë që arti barok është shprehje e revolucionit kulturor që bëhet në emër të katolicizmit. Nxënësit do të njihen me përfaqësuesit kryesorë dhe me veprat e tyre, me dinamikën e zhvillimit të artit, me përsosjen e teknikave artistike dhe të gjuhës vizuale. Gjithashtu, me rëndësi të veçantë është afirmimi i subjekteve të reja artistike, karakteristikat e zhvillimit në vende të ndryshme.

| Nr | Tematika | Objektivat |
|----|---|--|
| 4. | Arti barok (shekulli XVII - XVIII) | <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njojin zhvillimin e artit barok dhe vendet ku u zhvillua. - shpjegojnë diferençat kulturore midis vendeve të ndryshme dhe artistëve të tyre. - shpjegojnë zhvillimin e artit; - argumentojnë pse arti në këtë periudhë ishte në shërbim të fesë dhe politikës. - njojin veprat e autorëve kryesorë të kësaj periudhe. - shpjegojnë zhanret kryesore dhe evoluimin e teknikave artistike. |

5.Arti i kohës së re (shekujt XVII - XX)

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e artit pamor:

Neoklasizmi, arti romantik, arti realist, arti në fund të shekullit XIX (art - nuovo, impresionizmi, postimpresionizmi etj.), (arkitektura, piktura, skulptura) dhe përfaqësuesit kryesorë të këtyre periudhave. Nxënësit mësojnë dhe kuptojnë ndikimet dhe karakteristikat e mbi artin e këtyre periudhave. Në *Neoklasicizëm*, artistët u referohen formave të antikitetit grek dhe romak; Neoklasizmi është shprehje e mendimit iluminist. *Arti romantik* lartëson ndjenjet dhe fantazinë, emocioni dhe intuita e udhëheqin njeriun në njohjen e botës dhe të ngjarjeve. *Realizmi* është një lëvizje e mendimit, që interpreton transformimin e thellë shoqëror që ndodhi në Europë me revolucionin industrial. Dekorativiteti i *artit nuovo* dhe risitë që solli në konceptin e dizajnit. *Impresionizmi* - një rrymë që i hapi rrugë kërkimit shkencor në art. Në *postimpresionizëm* arti bëhet mjet reagimi ndaj modeleve të shoqërisë borgjeze, artistët përfaqësues shprehin dimensionin e tyre personal me një gjuhë të re shprehëse.

| Nr | Tematika | Objektivat |
|----|---|--|
| 5. | Arti i kohës së re (shekujt XVII - XX) | <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none">- njohin zhvillimin e artit të Kohës së Re.- shpjegojnë zhvillimet historike, terrenin social ekonomik ku u zhvilluan.- kuptojnë Revolucionit tekniko shkencor dhe risitë.- shpjegojnë ndarjen e epokave dhe dallimet midis rrymave.- njohin veprat dhe autorët kryesorë të kësaj periudhe.- shpjegojnë zhvillimet teknologjike dhe jetën moderne. |

6.Arti në shekullin XX

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e artit pamor dhe përfaqësuesit kryesorë: *Arti në gjysmën e parë të shekullit XX: Piktura, arkitektura, skulptura (sovizmi, kubizmi, abstrakcionizmi, ekspresionizmi, futurizmi, surrealizmi, dadaizmi etj.).*

Arti në gjysmën e dytë të shekullit XX: Piktura, arkitektura, skulptura (pop arti, arti optik, ekzibicionizmi, neorealizmi, hiperealizmi, postmodernizmi etj.), (arkitektura, piktura, skulptura).

Në këtë periudhë, vitet e para të 1900-ës karakterizohen për eksperiencat e reja në fushat e letërsisë, filozofisë dhe artit. Arti i së kaluarës vihet në diskutim, duke refuzuar idenë që arti duhet të kopjojë natyrën. Në gjurmët e postimpresionistëve formohen lëvizje të reja që quhen avangardë, periudhë e cila hap një epokë të re për artin në lidhje me të gjithë zhvillimet politike, ekonomike, sociale. Përmes njohjes së zhvillimit të artit nga një lëvizje artistike tek tjetra, nxënësit njihen edhe me artistët më përfaqësues dhe me veprat e tyre kryesore.

| Nr | Tematika | Objektivat |
|----|-----------------------------|---|
| 6. | Arti në shekullin XX | <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njojin zhvillimin e artit në shekullin XX. - Të shpjegojnë rolin e politikës dhe të ekonomisë. - njojin dhe të përcaktojnë artistët novatorë. - shpjegojnë ndryshimet e vazhdueshme të artit në këtë periudhë; - përcaktojnë qartë rrymat artistike dhe autorët. - njojin veprat dhe autorët kryesorë të kësaj periudhe. - shpjegojnë ndryshimet në përbajtje dhe zhvillimet e teknologjisë. |

7. Arti figurativ shqiptar

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e artit shqiptar dhe përfaqësuesit kryesorë në këto periudha: *Arti ilir dhe i qyteteve antike bregdetare, arti bizantin, arti pas bizantin, arti i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, arti i periudhës së Pavarësisë, arti i periudhës pas Çlirimit (1945 deri më sot) (arkitektura, piktura, skulptura).* *Arti ilir dhe i qyteteve antike bregdetare:* Sistemi shoqëror dhe krijimi i kulturës autentike; ndikimi i fuqishëm nga kulturat e forta antike. *Arti bizantin:* Arti në shërbim të fesë dhe feja në shërbim në politikës; Shqipëria midis dy botëve; tiparet thelbësore. *Arti pas bizantin:* Shqipëria në pushtimin osman; piktura baras me besimin e krishterë. *Arti i Rilindjes Kombëtare Shqiptare:* Përpjekja për kompaktësi kombëtare dhe territoriale të shqiptarëve; ndikimet e artit romantik; Gjergj Kastrioti Skënderbeu - figurë thelbësore e epokës. *Arti i periudhës së Pavarësisë:* Themelimi i shtetit shqiptar dhe detyrat e reja për zgjidhje;

arti merr karakter profesionist dhe realist. *Arti periudhës pas Çlirimt (1945 deri më sot)(Arkitektura, Piktura, Skulptura)*: Çlirimi i Shqipërisë; zhvillime të rëndësishme në të gjitha fushat e artit në ndikimin e ideologjisë; kalimet pas viteve '90-të dhe zhvillimet e artit në trevat jashtë territorit të shtetit shqiptar.

| Nr | Tematika | Objektivat |
|----|--------------------------------|--|
| 7. | Arti figurativ shqiptar | <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohin zhvillimin e arkitekturës, skulpturës dhe artizanatit në artin ilir. - kuptojnë huazimet nga kulturat greke dhe romake në artin ilir. - bëjnë dallimin midis artit ilir dhe atij me ndikime greko-romake. - jasin shembuj konkretë me toponime dhe data. - njohin epokën kur lindi arti bizantin në Shqipëri. - njohin karakteristikat kryesore të artit bizantin. - përcaktojnë tiparet e veprave, dhe vendndodhjen e tyre. - njohin artistë të kësaj periudhe. - shpjegojnë pse Kristianizmi ishte sunduesi i botës shpirtërore të njeriut në këtë periudhë. - shpjegojnë pse piktura për njeriun është si Bibla për atë që di të lexojë. - njohin rolin vendimtar të pikturës pas bizantine, si themel i trashëgimisë historike, kulturore dhe shpirtërore. - njohin autorët kryesore të periudhës pas bizantine dhe veprat e tyre. - kuptojnë se si ndodhi shkëputja përfundimtare |

| | |
|--|--|
| | <p>nga arti mesjetar.</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegojnë tiparet kombëtare të artit të periudhës së Rilindjes, të shprehura në punët e artistëve patriotë me formim perëndimor. - përcaktojnë autorët dhe veprat e tyre në periudhën e Rilindjes Kombëtare. - kuptojnë rolin patriotik të krijimtarisë artistike në periudhën e Rilindjes Kombëtare. - njojin periudhën e Pavarësisë dhe zhvillimet sociale, ekonomike dhe politike. - shpjegojnë disa nga kërkesat që shtroheshin për zgjidhje dhe evolucionin e artit figurativ. - përcaktojnë risitë e artit shqiptar në periudhën e Pavarësisë. - njojin autorët kryesorë në skulpturë dhe pikture dhe veprat e tyre, në periudhën e Pavarësisë. - njojin rolin e artit në periudhën e realizmit socialist. - shpjegojnë çfarë është tabloja kompozicionale tematike në shërbim të ideologjisë. - kuptojnë rolin e institucioneve shtetërore artistike gjatë periudhës së viteve 1945 - 1990. - njojin skulpturat monumentale politike. - kuptojnë zhvillimet në varësi të trysnive politike. - njojin autorët kryesorë dhe veprat e tyre sipas gjinive të artit. - njojin autorët kryesorë të trevave shqiptare. |
|--|--|

4.TABELA E PESHËS SË TEMATIKAVE NË PËRQINDJE

| Nr. | Tematika | PËRQINDJA |
|-----|---|--------------|
| 1 | Arti figurativ në Antikitet (3000 vjet p.e.s – 400 e.s) | 10 % |
| 2 | Arti në Mesjetë (shekujt XI - XV) | 5 % |
| 3 | Rilindja Europiane (shekujt XV - XVII) | 10 % |
| 4 | Arti barok (shekujt XVII - XVIII) | 10 % |
| 5 | Arti i kohës së re (shekujt XVII - XX) | 15 % |
| 6 | Arti në shekullin XX | 15 % |
| 7 | Arti ilir dhe i qyteteve antike bregdetare | 5 % |
| 8 | Arti bizantin | 5 % |
| 9 | Arti pas bizantin | 5 % |
| 10 | Arti i Rilindjes Kombëtare Shqiptare | 5 % |
| 11 | Arti periudhës së Pavarësisë | 5 % |
| 12 | Arti i periudhës së pas Çlirimt (1945 deri më sot) | 10 % |
| | Gjithsej: | 100 % |